



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 405, datë 07.10.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi dhe Rexhep Karaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...};

Akuza: {...}: “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 76-25 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal;

{...}: “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 76-25 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal;

{...}: “Veprime që pengojnë zbulimin e së të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkesë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykim procedimi penal nr.20, viti 2020, për veprën penale “Kultivim bimësh narkotike”, të parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal; “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Luveda Dardha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.43, viti 2019”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Luveda Dardha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale me nr.24 viti 2020, në ngarkim të të pandehurit {...}, akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe për veprën penale “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga neni 274/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Piro Sota, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 121/a-3 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Lutfije Celami, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ahmet Metaliaj dhe Oltjona Goxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 100/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ahmet Metaliaj dhe Oltjona Goxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ardiana Bera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 248 dhe 186/3 të Kodit Penal”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ardiana Bera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/1 dhe 324/a/2 të Kodit Penal”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhurata Balla, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj.; të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Rezarta Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: ZVRRPP, etj.; Objekti: “Lirim dhe dorëzim sendi”.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ornela Naqellari (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Esmeralda Xhili si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bekteshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Emona Muçi dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Manjola Xhaxho, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 140, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR